



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DREJTORIA E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 858/Prot.
1

Tiranë, më 05.02.2014

LËNDA: DATAT E KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE PËR VITIN 2013 - 2014

DREJTUAR: DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE _____
ZYRËS ARSIMORE _____

PËR DIJENI: Instituti i Zhvillimit të Arsimit

Inspektorati Shtetëror i Arsimit Parauniversitar

TIRANË

Agjencia Kombëtare e Provimeve

TIRANË

**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe
Kualifikimeve**

TIRANË

Në mbështetje të Ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin Arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. , Datë 2014, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve" ju bëjmë me dije se:

1. Provimet me shkrim për shkallët e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2013- 2014 do të zhvillohen, më datën **03.05.2014**, ora **10-12.30**, në **Tiranë**, në mjedise të planifikuara nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit.

2. Programet e kualifikimit të vihen në shërbim të mësuesve kandidatë nga DAR/ZA-të, brenda periudhës **14 shkurt 2014**. Programet mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të IZhA-s.
3. Mësuesit kandidatë për provimet e kualifikimit, plotësojnë formularët e aplikimit për të marrë pjesë në procedurat e kualifikimit dhe dorëzojnë portofolat e tyre sipas profileve përkatës, brenda datës **28 shkurt 2014**.
4. Listat e kandidatëve për provimet e kualifikimit, së bashku me vlerësimet e portofolit, i harton DAR/ZA (sipas formatit të IZHA-s) brenda datës **21 mars 2014**.
5. Listat të shpallen publikisht dhe të qëndrojnë të afishuara në mjediset e DAR/ZA-ve gjatë periudhës **21-26 mars 2014**, në mënyrë që mësuesit kandidatë të kontrollojnë të dhënat dhe vlerësimet e portofolave të tyre.
6. **DAR** harton listat përfundimtare (duke përfshirë edhe ZA-të përkatëse) sipas **formatit të IZhA-s për hedhjen e të dhënave** dhe i dërgon në formë elektronike dhe zyrtare në MAS dhe IZhA brenda datës **28 mars 2014**. Pas kësaj date nuk bëhen ndryshime në listën e mësuesve kandidatë.

PLARENT NDRECA



SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

